



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 291, datë 08.09.2020

PËR
ZGJATJEN E AFATIT TË CAKTIMIT TË GJYQTARES SË SKEMËS SË DELEGIMIT
ZNJ.{...}, NË GJYKATËN E APELIT KORÇË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45, pika 4, shkronja “a” dhe pika 7, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të situatës dhe nevojave të Gjykatës së Apelit Korçë, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Zgjatjen e afatit të caktimit të gjyqtares së skemës së delegimit znj.{...}, në Gjykatën e Apelit Korçë, deri më datë 30.06.2021.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së skemës së delegimit, znj.{...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Apelit Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR